



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.536/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Nevzat Zumeri me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.08.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar** apeli Anr.536/2021 i paraqitur nga Nevzat Zumeri me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

## A r s y e t i m

Me datën 25.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Nevzat Zumeri me vendbanim në Gjermani, në të cilën pretendohet se gjate aplikimit për regjistrim për votues jashtë Kosovës është bërë një gabim teknik ashtu që në vend të Nevzat Zumerit është ngarkuar aplikimi i personit Admir Zumeri. Andaj paarshtuesi i apelit kërkon që të regjistrohet si votues Nevzat Zumeri.

Me datë 25.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se nga emailat e pranuar nuk kanë pranuar aplikacionin për regjistrim për Nevzat Zumerin, andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave për votuesit jashtë Kosovës

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që paarshtuesi i apelit gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk ka dërguar aplikacionin për regjistrim në emër të Nevzat Zumerit, kjo shihet nga përgjigja e KQZ-se e cila thekson se nuk kane pranuar asnjë aplikacionin për regjistrim në emër të Nevzat Zumerit, andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil*” dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më larte, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie të tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Nevzat Zumeri nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 536/2021 më datën 27.08.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.